VENDIM
Nr. 30, datë 27.6.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetari Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 17.07.2012 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr. 22/4 Akti, që i përket:

KËRKUES: Kreshnik Bushi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Financave

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 196, datë 30.01.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr. 00-2010-468, datë 05.03.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 18/1, 42/2, 44, 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, përfaqësuesin e kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 157, datë 05.10.2001, ka caktuar ndaj kërkuesit Kreshnik Bushi masën e sigurimit “arrest me burg” për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 234, 236, 274-25 të Kodit Penal.

2. Me vendimin nr. 173, datë 22.10.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, është ndryshuar masa e sigurimit nga “arrest me burg” në “arrest shtëpie”. Kjo masë arresti ka qëndruar deri në përfundimin e gjykimit të çështjes penale.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 132, datë 13.10.2003, në zbatim të ligjit nr. 8895, datë 16.05.2002 “Për dhënie amnistie”, ka vendosur pushimin e çështjes penale për kërkuesin Kreshnik Bushi.

4. Pas këtij vendimi, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin me kërkesëpadi me objekt: “Kompensim për burgim të padrejtë”.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 441, datë 12.11.2004, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë si dhe detyrimin e degës së Buxhetit të Shtetit, Laç-Kurbin, të dëmshpërblejë kërkuesin në vlerën 3 700 000 lekë si kompensim për burgim të padrejtë.

6. Mbi ankimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1134, datë 17.11.2005, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 441, datë 12.11.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

7. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 443, datë 20.09.2006, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, si dhe detyrimin e Thesarit të Shtetit, dega Laç, të kompensojë kërkuesin në vlerën 2 402 000 lekë.

8. Mbi ankimin e Prokurorisë së Rrethit Kurbin dhe Avokaturës së Shtetit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 196, datë 30.01.2008, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

9. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2010-468, datë 05.03.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit.

10. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 196, datë 30.01.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 00-2010-468, datë 05.03.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

11. Kërkuesi ka parashtruar se vendimet janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Argumentet, në mënyrë të përmbledhur, paraqiten si më poshtë:

11.1. Arsyetimi i vendimit nr. 196, datë 30.01.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë është absurd e jologjik.

11.2. Vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, duke cenuar të drejtën e kompensimit për burgim të padrejtë.

12. ***Subjektet e interesuara***, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Financave, nuk paraqitën prapësime me shkrim për çështjen objekt gjykimi.

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese
II

13. Në analizën e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata, paraprakisht, konstaton se ajo i vlerëson këto pretendime në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që i ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i standardeve kushtetuese (*shih vendimet nr. 31, datë 05.07.2011; nr. 22, datë 22.07.2009 dhe nr. 14, datë 03.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

A. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit

14. Lidhur me pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit nr. 196, datë 30.01.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë, kërkuesi ka parashtruar se vendimi është arsyetuar në mënyrë absurde dhe jologjike, duke parashtruar se çështja penale duhet të ishte pushuar për arsye se nuk provohej fajësia, dhe jo në bazë të ligjit "Për dhënie amnistie".

15. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Si një detyrim i sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës, vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 7, datë 09.03.2009; nr. 23, datë 23.07.2009, nr. 5, datë 02.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se një funksion tjetër i arsyetimit të vendimit është t'u demonstrojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër një vendim i arsyetuar i jep mundësinë palëve ta apelojnë atë, si dhe organeve të apelit ta shqyrtojnë. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë *(shih vendimin Sarban kundër Moldavisë, prg.98, datë 4 tetor 2005)*. GJEDNJ-ja është shprehur për arsyetimin e vendimeve se detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështje konkrete dhe natyrës së vendimit (*Hirvisaari kundër Finlandës, prg. 30, vendim i datës 27 shtator 2001*).

17. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit Tiranë, në dhënien e vendimit për mospranimin e kërkesës për kompensimin e burgimit të padrejtë, është bazuar në vendimin për pushimin e çështjes penale nr. 132, datë 13.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë të jetë i paarsyetuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Kjo gjykatë në

vendimin e saj ka parashtruar të gjitha pretendimet e palëve në këtë proces, ka analizuar dhe vlerësuar secilën prej tyre. Në përfundim, bazuar në kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 268 i Kodit të Procedurës Penale dhe nga ligji nr. 8895, datë 16.05.2002 "Për dhënie amnistie", ka vlerësuar moslegjitimimin e kërkuesit në ngritjen e padisë me objekt për kompensimin e burgimit të padrejtë. Lidhur me këtë kërkesë Gjykata e Apelit Tiranë ka respektuar dhe vendimin njësues nr. 3, datë 27.03.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin është përcaktuar rrethi i personave që legjitimohen të paraqesin padi me objekt për kompensimin e burgimit të padrejtë. Midis tyre ka përcaktuar se të drejtën për kompensim e kanë dhe "*të paraburgosurit që ishin ndaluar me urdhër të prokurorit kur çështja në ngarkim të tyre është pushuar nga gjykata ose prokurori, përjashto rastet e pushimit të çështjes për shkak amnistie*".

18. Gjykata arrin në përfundimin se nuk rezulton që vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm.

19. Sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit, për cenim të parimit të arsyetimit të vendimit, është i pabazuar.

B. Për pretendimin se vendimet janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, duke cenuar të drejtën e kompensimit për burgim të padrejtë

20. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit. Ndaj tij duhet të ishte pushuar çështja penale pasi nuk provohej të kishte kryer veprat penale për të cilat akuzohej, dhe jo në zbatim të ligjit nr. 8895, datë 16.05.2002 "Për dhënie amnistie". Duke zbatuar dispozitat e këtij ligji është cenuar e drejta për kompensimin e burgimit të padrejtë.

21. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar sipas të cilit, si rregull, interpretimi i ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve, rrethanave dhe provave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*mutatis mutandis vendimi nr. 7, datë 27.04.2005 i Gjykatës Kushtetuese*). Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 31, datë 05.07.2011; nr. 22, datë 22.07.2009 dhe nr. 14, datë 03.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në çështjen konkrete, objekt shqyrtimi është vendimi civil i Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës për kompensimin e burgimit të padrejtë, dhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me të cilin është vendosur mospranim rekursi. Këto vendime, ashtu sikurse u analizua më sipër, janë marrë në bazë të një vendimi penal të formës së prerë, me të cilin gjykata, bazuar në ligjin nr. 8895, datë 16.05.2002 "Për dhënie amnistie" ka vendosur pushimin e çështjes penale. Ky vendim penal nuk është objekt i kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese, si dhe lidhur me të kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike.

23. Në vështrim të standardit të mësipërm, si dhe nisur nga natyra e pretendimeve të kërkuesit mbi procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykata vlerëson se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë.

24. Përfundimisht, Gjykata arrin në konkluzionin se gjatë gjykimit të çështjes në ngarkim të kërkuesit Kreshnik Bushi, nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f", nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës[1].

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.
Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj.
Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Admir Thanza.

[1] Gjyqtarët B.Dedja, V. Kristo, A.Thanza janë shprehur për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2010-468, datë 05.03.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), pasi është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor.